



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2022

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Z. Edmond Lekaj

Z. Edmond Lekaj

Adresa: “Foto studio Nenshati” te Truma e Dugajve të reja

**SHKODËR**

I nderuar z. Lekaj,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr. 2005 (tonën) prot. datë 04.11.2022, dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) për informacion lidhur me ecurinë dhe fazën ku ndodhet kërkesa juaj e paraqitur për zbardhjen e emrave të bashkëpunëtorëve të dalë në dosjen hetimore gjyqësore në ngarkim të Zef Luc Lekaj, ju informojmë si më poshtë:

Së pari baza ligjore në kërkesën tuaj për informacion, është vendosur bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar“.

Por nga shqyrtimi i objektit të kërkesës vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dispozitave procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse të ligjit nr. 45/2015.

Ligji organik nr. 45.2015 normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, si ligj i posacëm, që gjen zbatim duke preluar mbi ligjin nr. 119.2014, i cili zbatohet për aq sa është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, por edhe me ligjin për arkivat pasi informacioni që kërkohet për vënie në dispozicion është dokumentacion arkivor.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, ju informojmë se :

Kërkesa nr. 20 Prot., dt. 22.01.2018 e shtetasit Edmond Lekaj i është drejtuar Autoritetit për z. Zef Leka (i ati). Kërkesa është trajtuar dhe mbyllur me Vendimin nr. 347, datë 05.10.2018 të Autoritetit. Materiali është dorëzuar me procesverbal datë 25.10.2018 në formatin CD.

Me shkresën nr. 20/3 prot., dt. 07.11.2018 i është drejtuar Autoritetit, Leticja Lekaj (e mbesa e Zef Lekaj) me kërkesën për zbardhjen e bashkëpunëtorëve për z. Zef Lekaj. Kërkesa është shqyrtuar nga Autoriteti në datën 22.11.2018 dhe Drejtoria e Informacionit i është drejtuar Drejtorisë së Arkivit me shkresën nr. 20/4 prot., datë 23.11.2018.

Nga Drejtoria e Arkivit është përgatitur përgjigja dhe është dorëzuar materiali, pranë strukturës përkatëse me qëllim trajtimin përfundimtar dhe mbylljen e praktikës në Autoritet.

Sapo të përfundojë shqyrtimi i materialit nga ana e Autoritetit, do të njoftoheni menjëherë me shkresë në adresën e paraqitur në kërkesën drejtuar Autoritetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Selami Zalli**

Konceptoi: L. Cocoli  
Datë: 08.11.2022